

## Karta e-parë e apostollit Pavël mbë Korinthianëtë.

### Krye 1.

- 1 Pavli, i-thërritur' apostoll i Jisu Krishtit me anë të dashurimit të Perëndisë, edhe vë-  
2 llaj Sosthen, Mbë kishën'e Perëndisë që është ndë Korinthë, *mbë* të-shënjtëruarëtë mbë Jisu Krishtinë, *mbë* të-thërrituritë shënjtorë, bashkë me gjith'ata që thërresënë mbë çdo vënt mb'emërin'e Zotit t'ënë Jisu Krisht, 3 t'atyreve edhe t'ënit; Hir *qoftë* mbë ju edhe paqtim prej Perëndisë Atit t'ënë, edhe prej Zotit Jisu Krisht.
- 4 I falem ndersë përherë Perëndisë t'im për ju, për *atë* hirin'e Perëndisë që udha mbë 5 ju me anë të Jisu Krishtit; Se ubëtë të-pasurë me anë t'ati mbë të-gjitha, mbë çdo 6 fjalë e mbë çdo të-diturë; Sikundrë dësh- 7 mim' i Krishtit uvërtetua ndër ju; Kaqë sa s'jetni prapa as mbë ndonjë dhurëti, dyke 8 priturë sbulesën'e Zotit t'ënë Jisu Krisht; I-cili edhe dot' u vërtetonjë juve gjer ndë funtt që të dilni faqe-bardhë ndë ditët të Zotit 9 t'ënë Jisu Krisht. Besnik është Perëndia, prej të-cilit uthërrittë ndë shoqërit të Birit t'ati Jisu Krisht, Zotit t'ënë.

- 10 Edhe u lutem juve, o vëllezër, me anë t'emërit të Zotit t'ënë Jisu Krisht, të thoni që të-gjithë gjithatë fjalë, edhe të mos jenë çarje ndër mest t'uaj, po të jini të-bashkuarë ngushtë, dyke pasurë gjithatë mëndje e gjithatë mendim. Sepse më rrëfyenë për ju, o vëllezër, ata *që janë prej shtëpis'* së Killoësë, 12 se ka grindje ndër mest t'uaj. Edhe këtë e them, se sicilido prej jush thotë, Unë jam i Pavlit, e un' i Apollojt, e un' i Qifajt, e un' i 13 Krishtit. Ndarë qënkërka Krishti? Mos Pavli ukryqëzua për ju? Apo mb'emërit të Pavlit 14 upagëzuatë? I falem ndersë Perëndisë, se asndonjë prej jush s'kam pagëzuarë, veç 15 Krispin' edhe Gainë; Që të mos thotë ndonjë prej jush, se mb'emërit t'im e pagëzova. 16 Pagëzova edhe shtëpin' e Stefanajt; veç këtyreve nukë di ndë pagëzova ndonjë tjetërë.
- 17 Sepse Krishti nukë më dërgoj që të pagëzonj, po që të lëçit ungjillinë; jo me dituri fjale, që të mos dalë i-kotë kryqi i 18 Krishtit. Sepse fjala e kryqit mb'ata që humbenë është marrësi, po mbë ne që shpëtojmë 19 më është fuqi Perëndie. Sepse është shkruarë. „Dotë humbas diturin'e të-diturëvet, edhe 20 dotë heth tej mënçerin'e të-mënçimvet.“ Ku është i-dituri? ku është shkronjësi? ku është kërkimtari i kësaj jetë? a nukë marrosi Perëndia 21 diturin'e kësaj jete? Sepse passi ndë diturit të Perëndisë bota nuk'e njohu Perën-

- dinë me anë të diturisë, i pëlqeu Perëndisë me marrësin' e të-lëçiturit të shpëtonjë
- 22 ata që besonjë. Sepse edhe Judhenjtë kërkonjë shënjë, edhe Grekëritë kërkonjë
- 23 dituri; Po neve lëçismë Krishtinë të-kryqëzuarë, *i-cili* mbë Judhenjtë *është* skandhall,
- 24 edhe mbë Grekëritë marrësi; Po mb'ata që janë thërriturë, Judhenj e Grekër, Krishti *është*
- 25 fuqi Perëndie edhe dituri Perëndie. Sepse marrësia e Perëndisë është më e-diturë se njerëzitë; edhe dobësira e Perëndisë është më e-fortë se njerëzitë.
- 26 Sepse e shihni të-thërrituritë t'uaj, o vëllezër, se ndër ju pas mishit ka jo shumë të-diturë, jo shumë të-fuqishim, jo shumë të-
- 27 fisçim. Po Perëndia sgjodhi të-marrat' e botësë, që të turpëronjë të-dituritë; edhe Perëndia sgjodhi të-dobëtat' e botësë, që të turpëronjë të-fortatë; Edhe Perëndia sgjodhi të-pafisçimet' e botësë edhe ato që janë të-shara, edhe ato që nukë janë, qe të prisnjë ato
- 29 që janë; Që të mos mburretë çdo mish përpara ati. Edhe ju jeni prej ati mbë Jisu Krishtinë, *i-cili* ubë mbë ne dituri prej Perëndie, drejtëri edhe shënjtërim edhe çpër-
- 31 blim; Që, sikundrë është shkruarë, „Ay që mburretë, mbë Zotinë letë mburretë.“

## Krye 2.

- 1 Edhe unë, o vëllezër, kur erdha te ju,

- nukë erdha me lartësirë fjale a diturie, që
- 2 t'u dëftenj juve dëshmimin'e Perëndisë. Sepse e pashë të udhësë të mos di tjetërë gjë ndër ju, veç Jisu Krishtinë, edhe këtë të-
- 3 kryqëzuarë. Edhe un' erdha ndër ju me dobësirë e me frikë e me shumë të-dridhurë;
- 4 Edhe fjala ime edhe të-lëçituritë t'im nuk' ubënë me fjalë diturie njeriu që mbushnjënë mëndjenë, po me të-dëftyerë Fryme e fuqie;
- 5 Që të mos jetë besa juaj me anë të diturisë së njerësvet, po me anë të fuqis'së Perëndisë.
- 6 Edhe flasmë dituri ndër mest t'atyre që janë të-sosurë, po jo dituri të kësaj jete, as të urdhëtarëvet të kësaj jete, që prishenë;
- 7 Po flasmë dituri Perëndie ndë fshehësirë, atë të-fshehurënë që urdhëroj Perëndia që
- 8 përpara jetëvet për lavdinë t'ënë; Të-cilënë asndonjë nga urdhëtarët' e kësaj bote nuk' e njohu; sepse po t'e kishinë njohurë, nukë
- 9 dotë kishinë kryqëzuarë Zotin' e lavdisë; Po, sikundrë është shkruarë, „Ato që sy s'i pa, e vesh s'i dëgjoj, e ndë zëmërë njeriu nukë hipnë, këto Perëndia i bëri gati për ata që
- 10 e duan' atë.“ Po Perëndia na i sbuloj me anë të Frymës' së ti; sepse Fryma i vëzhgon
- 11 të-gjitha, edhe të-thellat' e Perëndisë. Sepse cili prej njerësvet njih punët' e njeriut, përveç fryma e njeriut që është nd'atë? Kështu edhe punët' e Perëndisë asndonjë s'i njih,
- 12 përveç Fryma e Perëndisë. Edhe neve s'kemi

- marrë frymën' e botësë, po Frymë në që është nga Perëndia, që të njohëm' ato që na janë
- 13 dhurëtuarë nga Perëndia. Për këto edhe flasmë, jo me *fjalë* të-mësuara prej ditoris' së njerësvet, po me *fjalë* të-mësuara prej Frymës'së-Shënjtëruarë, dyke mbarasuarë punëra shpirtërishte me punëra shpirtërishte.
- 14 Po njeriu i naturësë nukë pret punërat'e Frymës' së Perëndisë; sepse janë marrësi për atë, edhe nukë munt t'i njohë *ato*; sepse
- 15 *ato* gjykonenë shpirtërisht. Po njeriu i shpirtit i gjykon të-gjitha edhe vetë nukë gjykonetë as prej ndonjëj. Sepse cili e njohu mëndjen'e Zotit, që t'a mësonjë atë? po neve kemi mëndje Krishti.

### Krye 3.

- 1 Edhe unë, o vëllezër, nukë munda të flas mbë ju, posi mbë njerës të shpirtit, po posi mbë njerës të mishit, posi mbë foshnje mbë
- 2 Krishtinë; U ushqeva juve me qumësht, e jo me gjellë; sepse edhe nukë muntitë *t'a prtitë atë*, po edhe as ndashti nukë muntni;
- 3 Sepse edhe po jeni njerës të mishit; sepse gjersa ka ndër ju cmir e qartë e ndarje, a nukë jeni njerës të mishit, edhe ecëni pas
- 4 *mënyrës' se* njeriut? Sepse kur thotë njëri, Unë jam i Pavlit, edhe tjetëri, Unë jam i Apollojt, a nukë jemi njerës të mishit?
- 5 Cili pra është Pavli, e cili Apolloj, për-

- veç se shërbëtorë, me anë të të-cilëvet be-suatë, edhe sikundrë i dha Zoti gjithë-sicilit?
- 6 Unë mbolla, Apolloj ujit, po Perëndia i rriti.
- 7 Kështu pra as ay që mbjell nuk'është gjë,
- 8 as ay që ujit, po Perëndia që rrit. Edhe ay që mbjell edhe ay që ujit janë një; edhe gjithë-sicili dotë marrë pagën'e ti si pas mundit të ti. Sepse neve jemi punëtorë bashkë me Perëndinë; ju jeni ar' e Perëndisë, ndërtesa e Perëndisë.
- 10 Unë pas hirit të Perëndisë që m'udha, si *ndonjë* kryemjeshtër i-diturë hodha themel; e një tjetërë ndërton mbi *atë*; po gjithë-sicili letë vërë re qysh ndërton mbi *atë*. Sepse asndonjë nukë munt të vërë tjetërë themel, përveç ati që është vënë, i-cili është Jisu Krishti.
- 12 Edhe ndë ndërtoftë ndonjë mbi këtë themel, ar, ergjënt, gurë të-paçëmuarë, dru, bar, kallam; E gjithë-sicilit puna dotë çfaqetë; sepse dita dot'a tregonjë *atë*; sepse me anë të zjarrit nxiretë ndë shesh; edhe zjarri dotë provonjë punën' e sicilitdo ç'farë *pune* është.
- 14 Ndë mbettë puna e ndonjëjtë që ndërtoj, dotë
- 15 marrë pagë; Ndë udjëktë puna e ndonjëjtë, dot' i bënëtetë dëm; po ay vetë dotë shpëtonjë, posi prej zjarrit.
- 16 Nuk' e dini se jeni tempull Perëndie,
- 17 edhe Frym' e-Shënjtëruarë rri ndër ju? Ndë prishhtë ndonjë tempullin'e Perëndisë, këtë dota prishnjë Perëndia; sepse tempulli i Pe-

18 rëndisë, i-cili jeni ju, është i-shënjtëruarë. As-  
ndonjë letë mos gënjënjë vetëhen' e ti; ndë  
panden ndonjë ndër mest t' uaj se është i-  
diturë ndë këtë botë, letë bënet' i-marrë, që  
19 të bënetë i-diturë. Sepse dituria e kësaj bote  
është marrësi përpara Perëndisë. Sepse është  
shkruarë, „Ay që zë të-dituritë ndë dinakërit  
20 t'atyreve.“ Edhe përsëri, „Zoti njeh mendimet'  
e të-diturëvet se janë të-kotë.  
21 Përandaj asndonjë letë mos mburretë  
22 mbë njerës; sepse të-gjitha janë t'uajatë; A  
Pavli, a Apolloj, a Qifaj, a bota, a jeta, a  
vdekja, a këto që janë ndashti, a ato që  
23 dotë vinjënë; të-gjitha janë t'uajatë; Edhe  
ju, të Krishtit; edhe Krishti, i Perëndisë.

## Krye 4.

1 Kështu letë na numëronjë çdo njeri, si  
shërbërorë të Krishtit, edhe si kujdestarë të  
2 fshehësiravet të Perëndisë. E tjetëra që kër-  
konetë ndër kujdestarët është që të gjëndetë  
3 gjithë-sicili besëtar. Sa për mua fort pak  
gjë është të gjykonem prej jush, a prej gjyqi  
njeriu; po as vetë vetëhenë nuk' e gjykon.  
4 Sepse ndërgegja ime nukë më qërton për  
asgjë; po me këtë nukë jam i-drejtëruarë;  
5 po Zoti është ay qe më gjykon. Përandaj mos  
gjykoni as gjë përpara kohësë, gjersa të vi-  
një Zoti; i-cilli edhe dotë nxjerrë ndë dritë  
të-fshehurat' e errësirësë, edhe dotë çfaqnjë

këshillat' e zëmëravet; edhe atëhere lëvdimi  
dotë bënetë mbë gjithë-sicilinë nga Perëndia.  
6 Edhe këto, o vëllezër, për shëmbëllë i  
ktheva përmbi vetëhenë t'ime edhe përmbi  
Apollonë, për të-mirënë t'uaj; që të mësohi  
prej nesh të mos mendoni me tepërë nga  
ç'është shkruarë, që të mos madhështonetë  
ndonjë prej jush për njërinë kundër tjetërit.  
7 Sepse cili të çquan ty nga tjetëri? edhe ç'gjë  
ke ti që nuk' e more? Edhe ndë e ke marrë,  
ç'burrësh sikur se nuk e ke marrë?  
8 Ndashti jeni të-nginjurë, ndashti ubëtë  
të-pasurë, mbretëruatë pa neve; edhe makar  
të kishitë mbretëruarë, që edhe neve të mbre-  
9 tëronimë bashkë me ju. Sepse më duketë  
se Perëndia neve apostojtë na tregoj për  
më të-poshtërit' e njerësve, si të-dënuarë ndë  
vdekje; sepse ubëmë lodrë ndë botët, ndë  
10 ëngjëjt e ndë njerëzit. Neve jemi të-marrë  
për Krishtinë, e ju të-mëncim mbë Krish-  
tinë; neve të-dobëtë, e ju të-fortë; ju të-lav-  
11 duruarshim, e neve të-çnderuarë. Gjer mbë  
këtë orë edhe uri kemi, edhe et kemi, e të-  
sveshurë jemi, e me shuplaka rrihemi, e si-  
12 llemi andej e këtej, E mundonemi dyke pu-  
nuarë me duartë t'ona; kur përqeshemi, be-  
13 kojme; kur ndiqemi, durojme; Kur shahemi,  
lutemi; ubëmë posi të-fshirat' e botësë, posi  
lëmishtet' e të-gjithëve gjer mbë këtë ditë.  
14 Nukë shkruanj këto për të turpëruarë

juve, po u këshillonj juve posi bij të mi të-  
 15 dashurë. Sepse ndë paçi dhjetë mijë mëso-  
 njës mbë Krishtinë, po *nukë kini* shumë atër;  
 sepse unë u polla mbë Krishtinë Jisu me  
 16 anë të ungjillit. U lutem juve pra të bëni  
 17 si bënj unë. Përandaj u dërgova juve Timo-  
 thenë, i-cili është biri im i-dashurë edhe be-  
 sëtar mbë Zotinë; ky dot' u sjellë juve ndër  
 mëntt udhët' e mia që janë mbë Krishtinë,  
 sikundrë mëson kudo mbë çdo kishë.  
 18 Po ca *veta* umadhështuanë, sikurse unë  
 19 s' kishnjam për të ardhurë ndër ju; Po çpejt  
 kam për të ardhurë ndër ju, ndë dashtë Zoti,  
 edhe kam për të njohurë jo fjalën' e atyreve  
 20 që madhështonenë, po fuqinë. Sepse mbre-  
 tëria e Perëndisë nuk' është me fjalë, po me  
 21 fuqi. Ç'doni? me shkop të vinj ndër ju, apo  
 me dashuri e me frymë butësire?

#### Krye. 5.

1 Gjithëzaj dëgjonetë ndër ju kurvëri, edhe  
 e-këtitillë kurvëri që as ndër kombet (nukë  
 zihetë n'gojë), kaqë sa një të ketë gruan' e t'et.  
 2 Edhe ju jeni madhështuarë, e nukë bëtë vajë  
 me të-tepërë, që të ngrihetë nga mezi juaj  
 3 ay që bëri këtë punë? Sepse unë, ndonëse  
 s'jam aty me trupinë, me shpirtinë jam aty,  
 edhe sikurse jam aty kam gjykuarë ndashti  
 për këtë njeri që bëri të-këtitillënë punë, që,  
 4 Mb' emërit të Zotit t'ënë Jisu Krisht, passi

të mblidhi ju edhe shpirti im me fuqinë Zo-  
 5 tit t'ënë Jisu Krisht, T'a epni të-këtitillinë *njeri*  
 ndë dorët të Satanajt për prishjen' e mishit, që  
 t' i shpëtonjë shpirti ndë ditët të Zotit Jisu.  
 6 Nuk'është të-mirë të-mburruritë t'uaj; nukë  
 dini se pak brumë mbruh gjithë të-mbrujtu-  
 7 ritë? Qërohi pra nga brumi i-vjetërë, që të  
 jini të-mbrujturë të-ri, sikundrë jeni pa brumë;  
 sepse pashka jonë, që është Krishti, ubë kur-  
 8 ban për ne. Përandaj letë kremtërojmë jo me  
 brumë të-vjetërë, as me brumë keqësie e  
 ligësie, po me të-pambrumura *bukë* zëmëre  
 së-kthjellëtë e së-vërtetë.  
 9 U shkrova juve ndë kartët, të mos për-  
 10 zihni me kurvarë; Edhe jo fare të *mos për-*  
*zihni* me kurvarët' e kësaj bote, a me lak-  
 mimtarëtë, a me rrëmbenjësitë, a me idhulla-  
 trëtë; sepse atëhere duhetë të dilni jashtë  
 11 nga bota. Po ndashti u shkrova juve, të mos  
 përzihi, ndë qoftë se ndonjë që quhetë vëlla  
 është kurvar, a lakmimtar, a idhullatër, a  
 përqeshës, a pianec, a rrëmbenjës; me të-ti-  
 12 llinë as të mos hani bashkë. Sepse ç'më du-  
 hetë të gjykonj edhe të-jashtëshmitë? Nukë  
 13 gjykoni ju të-brëndëshmitë? Po të-jashtë-  
 shmitë Perëndia dot' i gjykonjë; përandaj  
 nxirni të-ligunë jashtë nga mezi juaj.

#### Krye 6.

1 Kuxon ndonjë prej jush, kur ka ndonjë

- gjë kundrë tjetërit, të gjykonetë përpara të-shtrëmbërvet, e jo përpara shënjtorëve? Nukë dini se shënjtorëtë dotë gjykonjënë botënë? edhe ndë bota gjykonetë prej jush, nukë jini
- 3 të-zotër të gjykoni më të-vogëla *punëra*? Nuk' e dini, se dotë gjykojmë engjëj? sa më tepërë
- 4 *punëra* të kësaj jete? Ndë kini pra *punëra* të kësaj jete për të gjykuarë, ata që nukë zihenë për gjë ndë kishët, këta vini gjykatës. Për turp t'uaj ua them *këtë*. Kështu nukë qënka ndër mest t'uaj as një i-urtë, i-cili të muntjë të gjykonjë ndër mest të vëllajt të ti?
- 6 Po gjykonetë vëlla me vëlla, edhe kjo *bënetë*
- 7 përpara të-pabesëve? Ndashti pra është faj i-math ndër ju të kini gjyqe njeri me tjetërinë. Përse më mirë nukë lini t'u bënetë juve paudhëri? Përse më mirë nukë lini t'u bënetë
- 8 dëm juve? Po ju bëni paudhëri e bëni dëm, edhe këto *u'a bëni* vëllezërvet.
- 9 Apo nukë dini se të-shtrëmbëritë nukë dotë trashëgonjënë mbretërin' e Perëndisë? Mos gënjeji; as kurvarë, as idhullatrë, as ndyrës, as të-sqaqurë, as ata që venë prapa
- 10 meskujsh, As vjedhës, as lakmimtarë, as pianikë, as përqeshës, as rrëmbenjës, nukë dotë trashëgonjënë mbretërin' e Perëndisë.
- 11 Edhe të-këfillë ishitë ca *prej jush*; po ulatë, po ushënjtëruatë, po udrejteruatë, me anë të emërit të Jisu Krishtit, edhe me anë të Frymës' së Perëndisë t'ënë.

- 12 Të-gjitha janë ndë pushtett t'im, po të-gjitha nukë bënëjnë dobi; të-gjitha janë ndë pushtett t'im, po unë nukë pushtonem as prej
- 13 ndonjë gjëje. Gjellëtë janë për barkunë, edhe barku për gjellëtë; po Perëndia edhe këtë edhe ato dot' i prishnjë. Po trupi nuk' *është* për kurvërinë, po për Zotinë, edhe Zoti për
- 14 trupinë; Edhe Perëndia edhe Zotinë e ngjalli, edhe neve dotë na ngjallnjë me anë të
- 15 fuqis' së ti. Nuk' e dini, se trupetë t'uaj janë anë të Krishtit? të marr pra unë anët' e Krishtit, e t'i bënj ato anë kurve? Qoftë lark!
- 16 A nuk' e dini se ay që ngjitetë me kurvënë është një trup *me atë*? sepse „dotë jenë,“
- 17 thotë, „të dy ndë një mish.“ Po ay që ngjitetë me Zotinë, është një frymë *me atë*. Largoni kurvërinë; Çdo faj që bën njeriu, është jashtë trupit; po ay që kurvëron fëjen mbë
- 19 trupt të vetëhes'së ti. Apo nuk' e dini se trupi juaj është tempull i Frymës' së-Shëntëruarë që *rr*i ndër ju, të-cilën' e keni prej Perëndisë, edhe nukë jeni *të-zotërit*' e vetëhesë
- 20 s' uaj? Sepse ubletë me çëmim; lavduron pra Perëndinë me trupinë t' uaj, edhe me shpirtinë t' uaj, që janë të Perëndisë.

## Krye 7.

- 1 Edhe për ato *punë* që më shkruatë, mirë është për njerinë të mos i mbështetetë gruaje.
- 2 Po për kurvëritë letë ketë gjithë-sicili gruan' e

- 3 ti, edhe gjithë-sicila letë ketë burrën' e saj. Burri let' i apë gruasë atë dashurinë që i ka detyrë; gjithashtu edhe gruaja burrit. Gruaja s' e urdhëron trupin' e saj, po burri; gjithashtu edhe burri nuk' e urdhëron trupin' e ti, po gruaja. Mos j' a shterni njëri tjetërit, përveç se ndë kini lidhurë fjalë për gjer mbë një kohë, që të bini pas agjërimit e pas të-falurit, edhe përsëri mblidhuni bashkë që të mos u ngasë
- 6 Satanaj për të-mos-përmbajturitë t' uaj. Edhe këtë po e them prej mëndjesë s' ime, jo prej urdhëri. Sepse dua gjithë njerëzitë të jenë si edhe vetëheja ime; po gjithë-sicili ka dhuratë të-veçantë nga Perëndia, njëri kështu, e tjetëri ashtu.
- 8 Edhe po u them të-pamartuarëvet edhe të-vavet, se është mirë për ata, ndë mbeçinë si edhe unë; Po edhe ndë mos përmbanjënë dot vetëhen' e tyre, letë martonenë; sepse është më mirë të martonetë *njeriu* se të nxehetë.
- 10 Edhe të-martuarëtë i porosit, jo unë, po Zoti, të mos ndahetë gruaja nga burri; Po edhe ndë undaftë, letë mbetet' e-pamartuarë, a letë pajtonetë me burrin' e saj; edhe burri të mos e lërë gruan' e ti.
- 12 Edhe të-tjerëvet u them unë, jo Zoti, Ndë ka ndonjë vëlla grua të-pabesë, edhe ajo do të rronjë bashkë me atë, letë mos e lërë atë.
- 13 Edhe një grua që ka burrë të-pabesë, edhe

- ay do të rronjë bashkë me atë, letë mos e lërë atë. Sepse burr' i-pabesë është i-shënjtëruarë me anë të gruasë; edhe gruj' e-pabesë është e-shënjtëruarë me anë të burrit; sepse tjetrazi bijtë t' uaj dot' ishinë të-pëgërë;
- 15 po ndashti janë sënjtorë. Po ndë undaftë i-pabesi, letë ndahetë; Vëllaj a motëra nukë janë bërë robër ndë të-këtilia punëra; po
- 16 Perëndia na ka thirrurë ndë paqtim. Sepse ç'di ti o grua, ndë kë për të shpëtuarë burrinë? a ç'di ti, o burrë, ndë ke për të shpëtuarë gruanë? Po sikundrë Perëndia i ndau gjithë-sicilit, edhe sikundrë Zoti thërriti gjithë-sicilinë, kështu letë ecënjë; edhe kështu urdhëronj mbë gjithë kishëtë.
- 18 Uthërrit i-rrethprerë ndonjë ndë besët? letë mos e fshehnjë rrethpresjenë. I pa-rrethprerë
- 19 uthërrit ndonjë? letë mos rrethprietetë. Rrethpresja s' është gjë, edhe parrethpresja s' është gjë, po të-ruajturit' e porosivet të Perëndisë.
- 20 Gjithë-sicili mb' atë të-thërriturë që uthërrit'
- 21 mb' atë letë mbesë. Uthërrite *kur* jeshe rop? mos ki kujdes; po ndë munt të bënesh i-liruarë, përdor-e këtë më mirë. Sepse ay që uthërrit mbë Zotinë *kur* qe rop, është i-liruar' i Zotit; gjithashtu edhe ay që uthërrit *kur*
- 23 *qe* i-liruarë, është rop i Krishtit. Me çëmim
- 24 ubletë; mos bëhi robër njerëzish.. Gjithë-sicili, o vëllezër, mb' atë që uthërrit, mbë këtë letë mbetetë ndaj Perëndisë.

- 25 Edhe për vërgjëreshatë s' kam urdhërë nga Zoti; po ap mëndje si i-përdëllyerë prej
- 26 Zotit të jem besëtar. Pandenj pra se këjo është e-mirë për nevojën'e-tanishimë, se është
- 27 mirë për njerinë të jetë kështu. Je lidhurë me grua? mos kërko të-sgjidhurë. Je sgjidhurë nga grua? mos kërko grua. Po edhe ndë umartofsh, nukë fëjeve; edhe vërgjëresha ndë umartoftë, nukë fëjeu; po të-ketillëtë dotë kenë shtrëngim ndë misht; e un'u kursenj juve.
- 29 Edhe këtë e them, o vëllezër, se koha paskëtaj është e-shkurtërë; kaqë sa edhe ata që kanë gra të jenë posikur s'kanë; edhe
- 30 ata që qanjënë, posikur s'qanjënë; Edhe ata që gëzonenë, posikur s'gëzonenë; edhe ata që blenjënë, posikur s'i kanë ndënë urdhërë-
- 31 rit të tyre; Edhe ata që përdornjënë këtë botë, posikur s'e përdornjënë; sepse forma
- 32 e kësaj bote shkon. Edhe dua të jini pa kujdese; i-pamartuari ka kujdes për punërat'e
- 33 Zotit, qysh t'i pëlqenjë Zotit; Po i-martuari ka kujdes për punërat'e botësë, qysh t'i pëlqenjë gruasë. Ndan gruaja prej vërgjëreshësë; e-pamartuara ka kujdes për punërat'e
- 34 Zotit, që të jet' e-shënjtëruarë edhe ndë trupt edhe ndë shpirtt; e-martuara ka kujdes për punërat'e botësë, qysh t'i pëlqenjë burrit.
- 35 Edhe këtë po u'a them juve për të-mirënjë t'uaj; jo që t'u vë lak, po që të jini të-

- hieshim edhe të-ngjiturë pas Krishtit pa kujdese.
- 36 Po ndë kujton ndonjë se silletë shëmtuarë mbë vërgjëreshën'e ti, ndë i shkoftë lul' e kohës' s' asaj *pa martuarë*, edhe duhetë të bënetë kështu, letë bënëjë ç' të dojë; nukë fëjen; letë martonenë. Po ay që rri i-qëndruarshim ndë zëmërët, e s'ka nevojë, po ka pushtet për dashurimin'e ti, edhe e vendosi ndë zëmërët të ti të ruanjë vërgjëreshën'e ti,
- 37 bën mirë. Përandaj edhe ay që e marton *vërgjëreshënë*, bën mirë; edhe ay që s'e marton, bën më mirë.
- 39 Gruaja është lidhurë (nga nomi) për sa kohë rron burr' i asaj; po ndë i vdektë burri, është e-liruarë të martonetë me cilinë të dojë,
- 40 vetëmë *këjo punë të bënetë* mbë Zotinë. Po sipas mëndjesë s'ime, më e-lumurë është, ndë mbettë kështu; edhe më duketë, se edhe unë kam Frymë Perëndie.

#### Krye 8.

- 1 Edhe sa për kurbanët' e idhujvet, dimë, se të-gjithë kemi dituri; *po* diturla madhështon,
- 2 e dashuria ndërton. Ndë i duketë ndonjë se di gjë, *ky* edhe nukë mësoj asgjë sikundërë duhetë të mësonjë; Po ndë do ndonjë
- 3 Perëndinë, *ky* është i-njohurë prej ati. Për të-ngrënëjtë pra e kurbanëvet që bënenë mbë idhujtë, e dimë se idhulli s' është asgjë ndë

botët, edhe se nukë ka tjetërë Perëndi veç  
 5 një. Sepse ndonëse ka asish që thuhënë pe-  
 rëndira, a ndë qiellit, a mbi dhët; (sikundrë  
*thuhetë se* ka shumë perëndira, edhe shumë  
 6 zotër;) Po mbë ne *është* një Perëndi, Ati, prej  
 të-cilit janë të-gjitha, edhe neve mb' atë; edhe  
 një Zot, Jisu Krishti, me anë të të-cilit janë të-  
 7 gjitha, edhe neve me anë t'ati. Po nuk' është  
 mbë të-gjithë këjo dituri; sepse ca veta me  
 ndërgegjenë *se diç është* idhulli gjer sot e  
 hanë posi kurban mbë idhullinë, edhe ndër-  
 gegjja e atyreve dyke qën'e-dobëtë pëgëretë.  
 8 Po të-ngrënë të nukë na dorëzon te Pe-  
 rëndia; sepse as ndë hëngrëshimë, dotë ke  
 mi gjë më shumë; as ndë mos hëngrëshimë,  
 9 dotë kemi gjë më pak. Po shikoni semos  
 ky pushteti juaj bënë të pëngesë mbë të-do-  
 10 bëtitë. Sepse ndë të paftë ndonjë ty që ke  
 dituri, se rri ndë mësallë ndë tempull idhush,  
 ndërgegjja e ati që është i-dobëtë a nukë  
 dotë marrë kuxim të hajë kurbanëtë mbë  
 11 idhujtë? Edhe *kështu* për diturinë t'ënde dotë  
 humbasë vëllaj i-dobëtë, për të-cilinë Krihsti  
 12 vdiq. Edhe kur fëjeni ju kështu mbë vëlle-  
 zëritë, edhe plagosni ndërgegjen'e atyre të-  
 13 dobëtë, mbë Krishtinë kini fëjyerë. Përandaj  
 ndë qoftë se të-ngrënë të *im* skandhalis t'im  
 vëlla, s' kam për të ngrënë inish për gjithë  
 jetënë, që të mos skandhalis t'im vëlla.

## Krye 9.

1 Nukë jam *un'* apostoll? Nukë jam *un'* i-  
 liruarë? Nukë pashë *unë* Jisu Krishtinë, Zo-  
 tinë t'ënë? Nukë jeni ju puna ime mbë Zo-  
 2 tinë? Ndë mos jam apostoll mbë të-tjerë,  
 po pak-së-paku mbë ju jam; sepse mbë Zo-  
 3 tinë vulla e apostolisë s'ime jeni juve. Për-  
 gjigja ime mb'ata që më gjykonjënë është  
 4 këjo, Mos nukë kemi *edhe* neve pushtet të  
 5 ham'e të pimë? Mos nukë kemi *edhe* neve  
 pushtet të heqëmë me vetëhe një grua nga  
 motratë, sikundrë edhe të-tjerëtë apostoj,  
 6 edhe të vëllezërit'e Zotit, edhe Qifaj? A po  
 vetëm'unë edhe Varnava nukë kemi pushtet  
 7 të mos punojmë? Cili vete ndonjë herë ndë  
 luftë me të-prishura prej vetëhes'së ti? Cili  
 vë vesh të, edhe nukë ha nga pem'e ati? A  
 cili kullot grigjë, edhe nukë ha nga qumështi  
 8 i grigjësë? Mos i flas *unë* këto *vetëmë* si  
 9 njeri? apo nukë thotë këto edhe nomi? Sepse  
 ndë nomt të Moisiut është shkruarë, „Nukë  
 dot' i lithç gojënë kaut që shin.“ Mos për  
 10 qetë ka kujdes Perëndia? A po për ne me  
 të-vërtetë e thotë këtë? sepse për ne u-  
 shkrua, se ay që lëron, me shpresë gian të  
 lëronjë; edhe ay që shin, *shin* me shpresë se  
 11 dotë ketë pjesë ndë shpresët të ti. Neve ndë  
 mbuallmë mbë ju gjërëratë shpirtëriake, *pun'*  
 e-madhe është ndë korçimë gjërëratë t'uaj

- 12 të-mishta? Ndë qoftë se të-tjerë marrënë pjesë të këti pushteti mbi ju, nukë gjan më tepërë neve? Po *neve* nuk' e përdormë këtë pushtet; po durojmë të-gjitha, që të mos bjemë ndonjë ndalim ndë ungjillit të Krishtit.
- 13 Nuk' e dini, se ata që bënëjënë *punërat* e shënjtëruara, prej hieroresë hanë? edhe ata që qëndronjënë përënë theroresë, marrënë
- 14 pjesë nga theroreja? Kështu edhe Zoti urdhëroj, që ata që lëçisnjënë ungjillinë prej ungjillit të rronjënë.
- 15 Po unë asndonjë nga këto nukë përdora, as nuk' i shkrova këto, që të më bënetë kështu; sepse është më mirë për mua të vdes, se të nxjerrë ndonjë të-mburruritë t' im të-
- 16 kotë. Sepse ndë lëçis ungjillinë, nuk' është të-mburrurë për mua; sepse këjo është një nevoj' e-madhe për mua; edhe mjerë unë, ndë
- 17 mos lëçica ungjillinë. Sepse ndë e bënj këtë dyke dashurë, pagë kam; po ndë e *bënj* dyke mos dashurë, më është zënë besë kujdesi. Cila pra është paga ime? *është* që me lëçitjenë t' ime t'a bënj ungjillin'e Krishtit të lëçitetë pa të-prishura, që kështu të mos e përdor për keq pushtetnë që kam mbë ungjillinë.
- 19 Sepse dyke qën' i-liruarë nga të gjithë, e bëra vetëhenë t' ime shërbëtuat mbë të-gjithë,
- 20 që te fitonj më të-shumëtë, Edhe ubëshë te Judhenjtë si Judhe, që të fitonj Judenitë; tek

- ata që janë ndënë nom *ubëshë* si ndënë nom,
- 21 që të fitonj ata që janë ndënë nom; Te të-panomëtë *ubëshë* si i-panom, (ndonëse nuk' ishnjam i-panom te Perëndia, po me nom
- 22 mbë Krishtinë,) që të fitonj të-panomëtë. Te të-dobëtitë ubëshë si i-dobëtë, që të fitonj të-dobëtitë; te të-gjith' ubëshë të-gjitha, që me
- 23 çdo mënyrë të shpëtonj ca veta. Edhe këtë e bënj për ungjillinë, që të bënem pjesëtar i ati.
- 24 Nuk' e dini, se ata që sulenë ndë shesht të lodravet të trimërisë, që të-gjithë sulenë, po një e merr bravurënë; kështu, suluni që
- 25 t'a merrni. Edhe kushdo që përpigëtë, e përmban vetëhenë nga të-gjitha; e ata e *bënjënë këtë*, që të marrënë një kurorë që prishetë po neve e *bëjmë, që të marrëmë kurorë* të-
- 26 pavidjershime. Unë pra kështu sulem, jo sikur jam ndë dyshim; kështu luftonj me grusht,
- 27 jo sikur rrah erënë; Po mundonj trupinë t' im edhe e bënj rop, semos, passi u lëçita të-tjerëve, unë hidhem poshtë.

## Krye 10.

- 1 Edhe nukë dua të mos dini ju, o vëllezër, se gjithë atëritë t'anë ishinë ndënë ret, edhe
- 2 të-gjithë shkuanë ndëpër dett; Edhe të-gjithë upagëzuanë mbë Moisinë ndë ret e ndë dett,
- 3 Edhe të-gjithë gjithatë të-ngrënë shpirtëriake
- 4 hëngrë; Edhe të-gjithë gjithatë të-pirë shpir-

- tëriake pinë; sepse pininë prej *një* guri shpirtëriak që u vinte pas; edhe *ky* gur ishte
- 5 Krishti. Po Perëndia më të-shumëtë nga ata nuk' i pëlqeu; sepse ranë të-vdekurë ndë shkretëtirët.
- 6 Edhe këto ubënë *për* shëmbëlla mbë ne që të mos dëshërojmë *edhe* neve punëra të-
- 7 liga, sikundrë dëshëruan' ata. As idhullatrë mos ubëni, posi ca *veta* nga ata, sikundrë është shkruarë, „Llauzi ndënji të haj' e të pijë,
- 8 edhe ungritnë të lozinë.“ As të mos kurvërojmë, sikundrë ca *veta* nga ata kurvëruanë, edhe ranë të-vdekurë mbë një ditë njëzet' e
- 9 tri mijë *veta*. As të mos ngasmë Krishtinë, sikundrë edhe ca nga ata e nganë, edhe u-
- 10 prishnë nga gjërpënjtë. As të mos murmurisni, sikundrë edhe ca nga ata murmurisnë, edhe
- 11 uprishnë prej *ëngjëllit* prishës. Edhe gjithë këto bëneshinë mb' ata për shëmbëlla, edhe ushkruanë për mësim mbë ne, mbë të-cilët
- 12 arrinë të-mbaruarat' e jetëvet. Përandaj ay që pandeh se qëndron, letë shohë semos bjerë poshtë.
- 13 *Tjatërë* ngasje nuk u ka gjeturë juve përveç se *ngasje* njeriu; po Perëndia është besëtar edhe nukë dot' u lërë juve të ngiteni tej fuqisë s' uaj, po bashkë me të-ngarëtë dot' u tregonjë udhë shpëtimi, që të muntni të duroni.

- 14 Përandaj, o të dashurit' e mi, largohuni nga idhullatria.
- 15 Flas posi mbë të-mënçim; gjyko-e-ni ju
- 16 atë që them. Potiri i bekimit që bekojmë, a nuk' është të-marrë pjesë ndë gjakt të Krishtit? Buka që thyejmë, a nukë është të-marrë
- 17 pjesë ndë trup të Krishtit? Sepse ne të-shumëtë jemi një bukë, një trup; sepse të-gjithë
- 18 kemi pjesë prej gjithasaj buke. Shikoni Israilinë pas mishit; ata që hanë kurbanëtë, a
- 19 nukë janë pjesëtarë te theroresë? Ç' them pra? se idhulli është gjë? apo se kurhani
- 20 mbë idhullinë është gjë? *jo*; Po *them*, se ato që bënëjnë kurban kombetë, u'a bënëjnë kurban djajvet, e jo Perëndisë; edhe
- 21 *unë* s' dua ju të bëhi pjesëtarë të djajvet. S' munt të pini potirin' e Zotit edhe potirin' e djajvet; nukë munt të jeni pjesëtarë të truvezës' së Zotit edhe të truvezës' së djajvet.
- 22 Apo Zotinë duamë t'a shtjemë mbë zili? mos jemi më të-fortë se ay?
- 23 Të-gjitha janë ndë pushtett t' im, po të-gjitha s' bënëjnë mirë; të-gjitha janë ndë push-
- 24 tett t' im, po të-gjitha s' ndërtonjënë. Asndonjë letë mos kërkonjë të-mirën' e ti; po gjithë-
- 25 sicili të tjetërit. Hani çdo gjë që shitetë ndë mish-shitoret, pa vëzhguarë gjë për ndër-
- 26 gjegenë; Sepse „dheu është' i Zotit, edhe të-
- 27 mbushurit' e ati.“ Edhe ndë u therritë juve ndonjë nga të-pabesëtë, edhe doni të vini,

hani çdo gjë që t'u vihetë përpara, pa vëzh-  
 28 guarë gjë për ndërgjegjenë. Po ndë u thëntë  
 juve ndonjë, Këjo është kurban idhulli, mos  
 hani, *edhe këtë* për atë që u dëftu, edhe për  
 ndërgjegjenë; (sepse „dheu është i Zotit, edhe për  
 29 të-mbushurit e ati.“) Edhe ndërgjegje them,  
 jo t'ëndenë, po të tjetërit; sepse përse të  
 gjykonetë liria ime prej ndërgjegjes' së tja-  
 30 tëri *njeriu*? Edhe ndë unë marr pjesë më të-  
 falurë ndersë, përse të shahem për atë për  
 31 të-cilinë unë falem ndersë? Ndë hëngrëshi  
 pra, a ndë pifshi, a ndë oëfshi gjë, të-gjitha  
 32 t'i bëni për lavdi të Perëndisë. Mos bëni  
 pëngesë as mbë Judhenj, as mbë Grekër, as  
 33 mbë kishën'e Perëndisë; Sikundrë edhe unë  
 mbë çdo gjë u pëlqenj të-gjithëve, sepse nukë  
 kërkonj të-mirënë t'ime, po *të-mirën'* e të-  
 shumëvet, që të shpëtonjënë.

#### Krye 11.

- 1 Bëni si bënj unë, sikundrë edhe unë *bënj*  
 si Krishti.
- 2 Edhe u lëvdonj juve, o vëllezër, se mbë  
 gjithë gjërërat më kujtoni, edhe mbani poro-  
 sitë që u lashë me gojë, sikundrë u'a dha-  
 shë juve.
- 3 Edhe dua t'a dini ju, se kryet' e çdo bu-  
 rri është Krishti; edhe kryet' e gruasë *është*  
 burri; edhe kryet' e Krishtit *është* Perëndia.
- 4 Çdo burrë kur falet' a kur profiteps, ndë

- pastë mbuluarë kryetë, turpëron kryet' e ti.  
 5 Edhe çdo grua, kur falet' a kur profiteps me  
 krye të-sbuluarë, turpëron kryet' e saj, sepse  
 është një e si-një-një me *gruanë* që ka rruarë  
 6 *kryetë*. Sepse ndë mos mbulonetë gruaja, edhe  
 letë qethetë. Po ndë *është* turp për gruanë  
 7 të qethetë, a të rruhetë, letë mbulonetë. Se-  
 pse burri nukë duhetë të mbulonjë kryetë,  
 sepse është figur' edhe lavdi e Perëndisë: po  
 8 gruaja është lavdi e burrit. Sepse burri nuk'  
 9 është prej gruasë, po gruaja prej burrit; Se-  
 pse edhe nuk' ukriua burri për gruanë, po  
 10 gruaja për burrinë. Përandaj gruaja duhetë  
 të ketë pushtet mbi kryet *të saj*, për ëngjëjtë.  
 11 Po mbë Zotinë as burrë *ka* pa grua, as grua  
 12 pa burrë. Sepse sikundrë gruaja *është* prej  
 burrit, kështu edhe burri *është* me anë të  
 gruasë; edhe të-gjitha *janë* prej Perëndisë.  
 13 Gjykoni *edhe* ju ndër vetëhet t'uaj; i ka  
 14 hije gruasë t'i faletë e-sbuluarë Perëndisë? Po  
 edhe natura vetë a nukë na mëson, se një  
 burrë ndë pastë leshëra të-gjata, këjo është  
 15 çnderim për atë? Po gruaja ndë ka leshëra  
 të-gjata, *këjo* është lavdi për atë; sepse leshë-  
 ratë i janë dhënë asaj ndë vënt mbulese.  
 16 Po ndë duketë ndonjë se do të bënjë  
 qarta, neve s' kemi të-këitillë zakon, as ki-  
 shët' e Perëndisë.  
 17 Edbe dyke porositurë këtë nuk' u lëvdonj,  
 se mblidheni jo për më të-mirënë, po për

- 18 më të-keqenë. Sepse më përpara, kur mbli-  
dheni ndë kishët, dëgjonj se ka çarje ndër  
mest t' uaj; edhe gjer mbë një shkallë besonj.
- 19 Sepse gjan të jenë edhe çarje ndër mest  
t' uaj, që të çfaqenë ata që janë të-vëjejturë  
ndë mest t' uaj.
- 20 Kur mblidheni pra bashkë mbë një vënt,  
*këjo* nuk' është për të ngrënë darkën' e Zotit;
- 21 Sepse mbë të ngrënë të gjithë-sicili merr më  
përpara se tjetëri darkën' e ti të-veçantë;  
edhe kështu njëri ka uri, edhe tjetëri është'
- 22 i-dejturë. Mos nukë keni shtëpira për të  
ngrën' e për të pirë? apo s' e zini për gjë  
kishën' e Zotit, edhe turpëroni ata që s' ka-  
në? Ç' t' u them juve? t' u lëvdonj për këtë?  
nuk' u lëvdonj.
- 23 Sepse unë mora prej Zotit atë që edhe  
u dhashë juve, se Zoti Jisuj mb' atë natë që
- 24 *dot'* epej ndër duar, mori bukë, Edhe si u-  
fal ndersë e theu, edhe tha, Merrni e hani; ky  
është trupi im që thyhetë për ju; këtë bëni
- 25 për kujtimnë t' im. Gjithashtu edhe potirinë,  
passi udarkua, dyke thënë, Ky potir është  
dhjata e-re mbë gjakunë t' im; këtë bëni sa
- 26 herë të pini, për kujtimnë t' im. Sepse sa he-  
rë të hani këtë bukë, edhe të pini këtë po-  
tir, rrëfeni vdekjen' e Zotit gjer mb' atë kohë  
që të vinjë.
- 27 Përandaj ay që të hajë këtë bukë, a të  
pijë potirin' e Zotit, pa qën' i-vëjejturë, dotë

- jetë fajtuar i trupit e i gjakut' të Krishtit.
- 28 Njeriu pra letë vëzhgonjë vetëhen' e ti, e  
kështu letë hajë nga *ajo* bukë, edhe letë pijë
- 29 nga *ay* potir. Se ay që ha e pi pa qën' i-vë-  
jejturë, ha e pi dënim për vetëhen' e ti, se-  
pse nukë çquan trupin' e Zotit. Përandaj ka
- 30 ndër mest t' uaj shumë të-dobët' edhe të-së-  
31 murë, edhe vdesënë mjatt *veta*. Sepse po të  
çquanimë vetëhenë t' ënë, nukë dotë gjyko-  
32 neshimë. Po kur gjykonemi, mundonemi prej  
Zotit, që të mos dënonemi bashkë me botënë.
- 33 Përandaj, o vëllezër, kur mblidheni për të  
34 ngrënë, pritni njëri tjetërinë. Po ndë i arhtë  
uri ndonjëj, letë hajë ndë shtëpit *të ti*, që të  
mos mblidheni për dënim. Edhe të-tjeratë,  
kur të vinj, dot' i vë mbë udhë.

## Krye 12.

- 1 Edhe për dhuratatë shpirtëriake, o vëlle-  
2 zër, nukë dua të jini të-paditurë. E dini, se  
ishitë gjindarë, dyke uhequrë sikundrë biqe-  
3 shitë pas idhujvet që s' kanë zë. Përandaj u  
bënj juve me diturë, se asndonjë që flet me  
Frymë të-Shënjtëruarë nukë thotë për Jisunë,  
qoft' i-mallëkuarë; edhe asndonjë nukë munt  
të thotë se Jisuj është Zot, veç me anë të  
Frymës' së Shënjtëruarë.
- 4 Edhe ka të-ndara dhuratash, po Fryma  
5 është gjithajo. Ka edhe të-ndara shërbeshash,  
6 po Zoti është gjithay; Ka edhe të-ndara pu-

- nërash, po Zoti është gjithay që punon të gjitha mbë të-gjitha.
- 7 Edhe gjithë-sicilit i epetë të-çfaqurit' e  
8 Frymësë për të-mirënë. Sepse njëj i epetë me anë të Frymësë fjalë urtësie, e tjtëri fjalë  
9 diturie, pas gjithasaj Fryme; Edhe tjtëri besë, me anë të gjithasaj Fryme; e tjtëri dhuratë  
10 shërimesh, me anë të gjithasaj Frymë; E tjtëri të-punuara çudirash, e tjtëri profiti, e tjtëri të-çquara frymash, e tjtëri çdo farë gjuhërash, e tjtëri të-përkthyerë gjuhërash;  
11 Edhe të-gjithia këto i punon një edhe gjithajo Frymë, dyke ndarë gjithë-sicilit dhurëtira veç e veç si të dojë vetë.
- 12 Sepse sikundrë trupi është një, edhe ka shumë anë, edhe gjithë anët' e një trupi, ndonëse janë shumë, bënjenë një trup, kështu edhe  
13 Krishti. Sepse neve të-gjithë jemi pagëzuarë me anë të gjithasaj Fryme mbë një trup, a Judhenj a Grekër, a robër a të-liruarë; edhe të-gjithë jemi ujiturë mbë një Frymë.
- 14 Sepse edhe trupi nuk' është një anë, po  
15 shumë. Ndë thëntë këmba, Sepse nukë jam dorë, nukë jam nga trupi; mos për këtë nuk'  
16 është nga trupi? Edhe ndë thëntë veshi, Sepse nukë jam sy, nukë jam nga trupi; mos për këtë nuk' është nga trupi? Po të ishte gjithë trupi sy, ku *dotë ishte* të-dëgjuarëtë? po të ishte gjithë trupi të-dëgjuarë, ku *dot' ishte*  
18 të-marrëtë erë? Po ndashti Perëndia ka vënë

- anëtë, gjithë-sicilënë nga ato, ndë trup, si  
19 deshi. Po ndë ishinë të-gjitha një anë, ku  
20 *dotë ishte* trupi? Po ndashti *janë* shumë anë,  
21 e një trup. Edhe syri s'munt t'i thotë dorësë, Nukë më duhe; a përsëri krej *t'u thotë*  
22 këmbëvet, Nukë më duhi. Po ato anë të trupit që dukenë se janë më të-dobëta, këto janë  
23 shumë më tepërë të-nevojshime. Edhe ato *anë* që na dukenë se janë më të-panderçimet' e trupit, këtyreve u bëjmë më shumë nder; edhe kështu të-shëmtuaratë t'ona kanë më  
24 tepërë hije; Po *anëtë* t'ona të-hijeshime nukë kanë nevojë. Po Perëndia, dyke dhënë më tepërë nder asaj *anë* që ka të-shtera, e  
25 bashkoj trupinë *me një të këtillë mënyrë*, Që të mos ketë çarje ndë trup, po të kenë gjithatë kujdes anëtë njëra për tjtërenë. Edhe ndë pësoftë një anë, gjithë anëtë pësonjenë bashkë me atë; a ndë nderoftë një anë, gjith' anëtë gëzonenë bashkë me atë.
- 27 Edhe ju jeni trupi i Krishtit, edhe anë  
28 veç e veç. Edhe Perëndia vuri ca *veta* ndë kishët, së-pari apostoj, së-dyti profitër, së-treti mësonjës, pastaj çudira, pastaj dhurata shërimesh, ndihmëra, qiverrira, farë gjuhërash.
- 29 Mos *janë* të-gjithë apostoj? mos *janë* të-gjithë profitër? mos janë të-gjithë mësonjës?  
30 Mos *bënjënë* çudira të-gjithë? Mos kanë të-gjithë dhurata shërimesh? mos flasënë gjuhëra të-gjithë? mos përkthenjenë të-gjithë?

31 Po lypni me zëmërë të-përvëluarë më të-miratë dhurata; edhe *dot'* u dëftenj juve një udhë shumë më të-lartë.

#### Krye 13.

- 1 Ndë folça gjuhërat' e njerëzet edhe t' ën-gjëjvet, e të mos kem dashuri, ubëshë *si* ramë që kumbon, a *si* qymvallë që tringëllin.
- 2 Edhë ndë paça profiti, edhe të-di gjithë fshe-hësi-*rat'* edhe çdo dituri, edhe ndë paça gjithë besënë, kaqë sa të tunt nga vëndi male,
- 3 e dashuri të mos kem, s'jam asgjë. Edhe ndë ndafsha gjithë gjënë t'ime për të ushqyerë *të-vobeqtë*, edhe ndë dhënça ndër duar trupnë t'im që të digjetë, e dashuri të mos kem, s' më bën as fare dobi.
- 4 Dashuria është zëmërë-gjerë, edhe bën të-mira; dashuria s' ka cmir; dashuria s' është e vrazhëtë, nukë mbahetë mbë të-math, S'bën punë të-shëmtuara, s' kërkon të-sajatë, nukë zëmëronetë, s' mendon të-ligënë; S'gëzonetë mbë shtrëmbërinë, po gëzonetë mbë të-vër-7 tetënë. Të-gjitha i mban, të-gjitha i beson, të-gjitha i shpren, të-gjitha i duron.
- 8 Dashuria kurrë s' bje poshtë. Po *të-tjeratë*, a profitira *qofshinë*, dotë bjenë poshtë; a gjuhëra, dotë pushonjënë; a dituri, dotë humbasë.
- 9 Sepse neve gjer mbë një shkallë dimë, edhe
- 10 gjer mbë një shkallë profitepsimë; Po kur të vinj' e-plota, atëhere ajo që është gjer

- 11 mbë një shkallë dotë prishetë. Kur ishnjam foshnje, si foshnje flisnjam, si foshnje kupë-tonjam, si foshnje mendonesha; po kur ubëshë
- 12 burrë, i hodha tej punërat' e foshnjesë; Sepse ndashti shohëmë mbë t'errët *si* ndëpër pas-qyrë, po atëhere *dotë shohëmë* faqe për faqe; ndashi njoh gjer mbë një shkallë, po atëhere dotë njoh sikundrë edhe unjohçë.
- 13 Edhe ndashti mbetetë besa, shpresa, dashuria, këto të tria; po m'e-madhja nga këto është dashuria.

#### Krye 14.

- 1 Ndiqni dashurinë; edhe lypni me zëmërë të-përvëluarë *dhuratatë* shpirtëriake, po më
- 2 tepërë që të profitepsni. Sepse ay që flet gjuhë *të-panjohurë* nuk' u flet njerëzet, po Perëndisë; sepse asndonjë s' e kupëton, po
- 3 me shpirtin' e ti flet fshehësira; Po ay që profiteps, u flet njerëzet për ndërtim e për
- 4 mësim e për ngushullim. Ay që flet gjuhë *të-huaj* ndërton vetëhen' e ti; po ay që profi-5 teps, ndërton kishënë. Edhe dua të-gjithë ju të flitni gjuhëra, po më tepërë të profitepsni; sepse ay që profiteps është më i-math se ay që flet gjuhëra, përveç ndë e përktheftë, që të marrë ndërtim kisha.
- 6 Edhe ndashti, o vëllezër, ndë arthça tek ju dyke folurë gjuhëra, ç' dobi dot' u bën juve, ndë mos u folça juve a me të-sbuluarë,

7 a me dituri, a me profiti a me mësim? Edhe ato që s' kanë shpirt e nxjerrënë zë, a fyell a qitharë, ndë mos dhëncinë zëre të-çquarë, si dotë njihetë të-rënit' e fyellit, a të-rënit' 8 e qitharësë? Sepse, ndë dhëntë trumbeta zë që s' kupëtonetë, cili dotë bënetë gati për 9 luftë? Kështu edhe ju, ndë mos dhënci me anë të gjuhësë zë që të kupëtonetë mirë, qysh dotë kupëtonet' ajo që flitetë? sepse dotë flisni nd' erët. Ndë botët mbase ndodhenë kaqë 10 farë zërrash, edhe asndonjë nga ata s' ështëë 11 që s' ka mendim. Ndë mos diça pra mendimn' e zërit, dotë jem një varvar tek ay që flet, edhe ay që flet, një varvar tek unë.

12 Kështu edhe ju, passi u përvëlonetë zëmëra për dhuratatë shpirtëriake, lypni të kini 13 të-tepëra për ndërtimn' e kishësë. Përandaj ay që flet gjuhë të-panjohurë, letë faletë që 14 të-bënet' i-zoti t'a kthenjë. Sepse ndë ufalça me gjuhë të-panjohurë, shpirti im faletë, po 15 mëndja ime nukë sjell pemë. Ç' duhetë pra? Dotë falem me shpirtinë, po dotë falem edhe me mënyrë që të kupëtohem; dotë psall me shpirtinë, po dotë psall edhe me mënyrë që 16 të kupëtohem. Sepse ndë lavdurofsh me shpirtinë, ay që ështëë nga rredhi i të-padituret, qysh dotë thotë Amin, kur ti falesh ndersë, 17 edhe ay nukë di seç thua. Sepse ti mirë falesh ndersë, po tjtatëri nukë ndërtonetë. I 18 falem ndersë Perëndisë t'im, se flas më

19 shumë gjuhëra se ju të-gjithë; Po ndë kishët dua më mirë të flas pesë fjalë me mënyrë që të kupëtohem, që të mësonj edhe të-tjerë, se dhjetë mijë fjalë me gjuhë të-panjohurë.

20 O vëllezër, mos bëhi çuna ndër mëntt; po bëhi foshnje mbë të-ligënë, edhe të-sosurë 21 rë ndë mëntt. Sepse ndë nomt ështëë shkruarë, „Se me të-tjera gjuhëra, e me të-tjera buzë, dot'i flas këti llauzi; po as kështu nukë 22 dotë më dëgjonjënë,“ thotë Zoti. Përandaj gjuhëratë janë për shënjë, jo mb'ata që besonjënë, po mbë të-pabesëtë; e profitia ështëë jo për të-pabesëtë, po për ata që besonjënë.

23 Ndë umblehtë pra gjithë kisha mbë një vënt, edhe të-gjithë të flasënë gjuhëra të-panjohura, e të hynjënë njerës të paditur'a të-pabesë, a nukë dotë thonë, se jeni të-shkalluarë?

24 Po ndë profitepsshinë të-gjithë, e të hynjë një i-pabesë a i-paditurë, ky qërtonetë prej 25 të-gjithëve, e gjykonetë prej të-gjithëve; Edhe kështu të-fshehurat' e zëmërës' s' ati çpërfaqenë; edhe kështu dotë bjerë me faqe përmbys, e dot'i faletë Perëndisë, dyke lëçiturë se Perëndia me të-vërtetë qënkërka ndër mest t'uaj.

26 Ç' duhetë pra, o vëllezër? Kur të mbli-dheni, gjithë-sicili prej jush të-psallurë ka, mësim ka, gjuhë ka, sbulesë ka, të përkthyerë gjuhërash ka, të-gjitha letë bënenë për

- 27 ndërtim. Ndë foltë ndonjë gjuhë të-panjohurë, let'a bënjënë këtë dy nga dy, a më të-shumënë tre nga tre, edhe këtë njëri pas tjetërit; edhe një letë përkthenjë; Po ndë mos pastë përkthenjës, letë heshtnjë ndë kishët, edhe letë flasë me vetëhen'e ti e me
- 29 Perëndinë. E profitër letë flasënë dy a tre,
- 30 edhe të-tjerëtë letë çquanjënë. Edhe ndë arthetë sbulesë ndonjë tjetëri që rri, i-pari letë
- 31 heshtnjë. Sepse munt njëri pas tjetërit të-gjithë të profitepsnjënë, që të nxënë të-gjithë,
- 32 edhe të-gjithë të ngushllonenë. Edhe frymërat'e profitërvet unjënë krye të profitëritë;
- 33 Sepse Perëndia nuk'është Perëndi trazimi, po paqtimi, sikundrë mbë gjithë kishët të shënjtorëvet.
- 34 Gratë t'uaj letë heshtnjënë ndë kishët, sepse nuk' u ndjenetë atyre të flasënë, po të unjënë kryetë, sikundrë edhe nomi thotë.
- 35 Po ndë duanë të nxënë gjë, letë pyesënë burrat'e tyre ndë shtëpit; sepse është turp për
- 36 gratë të flasënë ndë kishë. Apo prej jush dollari fjal'e Perëndisë? apo mbë ju vetëm' arriti?
- 37 Ndë i duketë ndonjë se është profit a njeri shpirtëriak, letë njohë se ato që u shkruan
- 38 anj juve janë porosi të Zotit; Po ndë mos di ndonjë këtë, letë mos e dijë. Përandaj,
- 39 o vëllezër, kërkoni me zëmërë të-përvëluarë të profitepsni, edhe mos ndaloni të flasënë

- 40 gjuhëra. Të-gjitha letë bënenë sikundrë ka hije e me udhë.

## Krye 15.

- 1 Edhe ndashti, o vëllezër, u dëftenj juve ungjillinë, që u ungjillëzova juve. të-cilin' edhe e muartë, mbë të-cilin' edhe qëndroni;
- 2 Me anë t'ati edhe shpëtoni, ndë e mbajçi atë, sikundrë u'a ungjillëzova juve, veç ndë
- 3 besuatë mbë kot. Sepse u dhashë juve më përpara atë që mora edhe unë, se Krishti
- 4 vdiq për fajetë t'anë, pas shkronjavet; Edhe se ukall ndë varrt, edhe se ungjall të-tre-
- 5 tënë ditë, pas shkronjavet; Edhe se i uduk
- 6 Qifajt, pastaj të dy-mbë-dhjetëvet; Pastaj uduk mbë më tepërë se mbë pesë qint vëllezër
- njëheresh, prej të-cilëvet më të-shumëtë rro-
- 7 njënë gjer sot, po ca kanë fleturë; Pastaj i
- 8 uduk Jakovit, pastaj gjithë apostojvet; Edhe më pastaj nga të-gjithë uduk edhe tek unë,
- 9 posi mbë një të-dështuarë. Sepse unë jam më i-vogëli i apostojvet, edhe s'jam i-vëjjeturë të quhem apostoll, sepse ndoqa kishën'e
- 10 Perëndisë. Po me hiri'e Perëndisë jam ç' jam; edhe hiri i ati që m'udha nuk'ubë i-
- kotë, po umunduashë më tepërë se ata të-gjithë; po jo unë, po hiri i Perëndisë që
- 11 është bashkë me mua. A unë pra, a ata, kështu lëçismë, edhe kështu besuatë.
- 12 Edhe ndë lëçitetë Krishti se ungjall prej

së-vdekurish, qysh ca veta ndër ju thonë,  
 13 se të-ngjallurë të-vdekurish nukë ka? Edhe  
 ndë mos ka të-ngjallurë të-vdekurish, as Kri-  
 14 shti nuk'ungjall; Edhe ndë mos ungjall Kri-  
 shti, pa fjalë të-lëçituritë t'ënë është të-kotë,  
 15 edhe besa juaj e-kotë; Edhe qënkemi edhe  
 dëshmitarë të-rrem të Perëndisë, sepse dësh-  
 muamë për Perëndinë, se ngjalli Krishtinë;  
 të-cilinë nuk'e paska ngjallurë, ndë qoftë  
 16 kështu se nukë ngjallënë të-vdekuritë. Sepse  
 ndë mos ngjallënë të-vdekuritë, as Krishti  
 17 nuk'ungjall. Po ndë mos ungjall Krishti, besa  
 juaj është e-kotë; edhe po jeni ndë fajet t'uaj;  
 18 Pa fjalë edhe ata që flejtnë mbë Krishtinë  
 19 janë të-humburë. Ndë shpërfshimë mbë Kri-  
 shtinë vetëmë mbë këtë jetë, jemi më të-  
 mjerët'e gjithë njerësvet.  
 20 Po ndashti Krishti ungjall prej së-vdeku-  
 rish; ubë pem' e-parë e atyre që kanë flej-  
 21 turë. Sepse sikundrë vdekja *erdhi* me anë  
 njeriu, *kështu* edhe të-ngjallurit' e të-vdeku-  
 22 ret *është* me anë njeriu. Sepse sikundrë të-  
 gjithë vdesënë mb' Adhaminë, kështu edhe  
 23 të-gjithë dotë marrënë jetë mbë Krishtinë; Po  
 gjithë-sicili ndë radhët të ti; Krishti *është*  
 pem' e-parë, pastaj sa janë të Krishtit, mbë  
 24 të-ardhurit t'ati *për së-dyti*; Pastaj *dotë jetë*  
 fundi, kur të apë mbretërinë ndë dorët të  
 Perëndisë edhe Atit; kur të prishnjë çdo ur-  
 25 dhër e çdo pushtet e fuqi. Sepse duhetë të

mbretëronjë ay, gjersa të vërë gjith' armiqtë  
 26 ndënë këmbët t'atia; I-pastajmi armik që  
 27 dotë prishetë *është* vdekja. Sepse „të-gjitha  
 i vuri poshtë ndënë këmbët t'atia;“ po kur  
 thotë, se të-gjitha janë vënë poshtë, merretë  
 vesh se mbetetë jashtë ay që vuri ndënë atë  
 28 të-gjitha. Edhe kur t' i unjënë kryetë ati të-  
 gjitha, atëhere edhe vetë Biri dotë unjë kry-  
 etë tek ay që vuri të-gjitha ndënë atë, që të  
 jetë Perëndia të-gjitha mbë të-gjitha,  
 29 Sepse ç' dotë bënëjënë ata që pagëzonenë  
 për të-vdekuritë? ndë qoftë se me të-vërtetë  
 nukë ngjallënë të-vdekuritë, përse edhe pa-  
 30 gëzonenë për të-vdekuritë? Përse edhe neve  
 31 jemi ndënë rrëzik mbë çdo orë? Përdita vdes,  
*edhe se është kështu bënëj be* mbë të-mbu-  
 rruritë *t'im* për ju që kam mbë Jisu Kri-  
 32 stinë, Zotinë t'ënë. Ndë si njeri luftova me  
 bisha ndë Efesët, ç' dobi kam, ndë qoftë se  
 nukë ngjallënë të-vdekuritë? „letë hamë e letë  
 33 pimë; sepse nesërë dotë vdesëmë.“ Mos gë-  
 njehi; *sepse* „Shoqërirra të-liga prishnjënë  
 vetia të-mira.“  
 34 Sgjohi mbë të-drejtënë, e mos fëjeni; sepse  
 ca veta nga ju nukë e njohënë Perëndinë;  
 për turp t'uaj po u'a them juve *këtë*.  
 35 Po dotë thotë ndonjë, Qysh ngjallënë të-  
 36 vdekuritë? edhe me ç' farë trupi vinjënë? O  
 i-marrë, atë që mbjell ti, nukë merr jetë, ndë  
 37 mos vdektë. Edhe atë që mbjell, nukë mbjell

atë trupinë që është për të bërë, po një koqe të-*sveshurë*, si të goditnjë, a gruri a ndonjë  
 38 tjetërë gjëje nga të-tjeratë. Po Perëndia i ep trup si të dojë, edhe gjithë-sicilësë nga fa-  
 39 ratë trupin' e saj të-veçantë. Çdo mish nuk' është gjithay mish; po tjetër' është mishi i njerëzet, e tjetërë mishi i bagëtivet, e tjetërë  
 40 i pishqet, e tjetërë i shpeset. Ka edhe trupe qielli, edhe trupe dheu; po tjetër' është lavdia e atyreve të qiellit, e tjetër' e atyreve të dheut.  
 41 Tjetër' është lavdia e djellit, e tjetërë lavdia e hënësë, e tjetërë lavdia e yjvet; sepse yll nga yll ndan ndë lavdit.  
 42 Kështu edhe të-ngjallurit' e të-vdekuret; mbilletë ndë prishje, e ngrihetë ndë paprishje;  
 43 Mbilletë ndë çnderim, e ngrihetë ndë lavdi; mbilletë ndë dobësirë, e ngrihetë ndë fuqi;  
 44 Mbilletë trup shtëze, e ngrihetë trup shpirti.  
 45 Ka trup shtëze, ka edhe trup shpirti. Kështu është edhe shkruarë, I-pari njeri, Adhami, „ubë frym' e-gjallë;“ i-pastajmi Adhami, shpirt që  
 46 ep jetë. Edhe nuk' ubë më përpara ajo e shpirtit, po ajo e shtëzësë, pastaj ajo e shpirtit.  
 47 Njeriu i-parë është prej dheut, i-balttë;  
 48 njeriu i dytë është Zoti prej qielli. I-çfarëtë është i-baltti, t' atillë *janë* edhe të-balttëtë; edhe i-çfarëtë është qiellori, t' atillë *janë* edhe  
 49 qiellorëtë. Edhe sikundrë veshmë figurën' e të-balttit, dotë veshmë edhe figurën' e qiello-  
 50 rit. Edhe këtë e them, o vëllezër, se mish

edhe gjak s' munt të trashëgonjë mbretërin' e Perëndisë, as prishja trashëgon paprishjenë.  
 51 Ja tek po u them juve një fshehësirë: të-gjithë nukë dotë flemë, po të-gjithë dotë ndë-  
 52 rronemi, Mbë një të-filmë, mbë një të-hedhurë të syrit, ndë trumbetët të-pastajme; sepse dotë bjerë trumbetë, edhe të-vdekuritë dotë ngja-  
 53 llenë të-paprishurë, edhe neve dotë ndërro-nemi. Sepse ky *trup* që prishetë duhetë të veshnjë paprishjenë, edhe ky *trup* që vdes duhetë të veshnjë pavdekjenë.  
 54 Edhe ky *trup* që prishetë kur të veshnjë paprishjenë, edhe ky *trup* që vdes kur të veshnjë pavdekjenjë, atëhere dotë bënë të fjala që është shkruarë, „Upërpi vdekja nga vito-  
 55 reja.“ „Ku është, o vdekje, thumbi yt? ku  
 56 është, o varr, vitorija jote?“ Edhe thumbi i vdekjesë është faji; edhe fuqia e fajit është  
 57 nomi. Po falemi ndersë Perëndisë që na dha vitorenë me anë të Zotit Jisu Krisht.  
 58 Përandaj, o vëllezërit' e mi të-dashurë, qëndroni të-fortë e të-patundurë, dyke tepëruarë përherë ndë punët të Zotit, sepse e dini se mundimi juaj nuk' është i-kotë mbë Zotinë.

#### Krye 16.

1 Edhe për të-mbledhurit' e ndihmëravet për shënjtoretë, sikundrë urdhërova kishët' e Galatisë, kështu bëni edhe ju. Të-parënë ditë të çdo jave gjithë-sicili prej jush letë vërë

- mbë nj'anë, e letë mbledhë atë që t'ja bënë  
 mbarë *Perëndia*, që, kur të vinj, të mos bë-  
 3 nenë atëhere të-mbledhura *ndihmërash*. Edhe  
 kur të vinj, ata që të sjiithni ju me kartëra  
 dot'i dërgonj, që të shpienë dhuratënë t' uaj  
 4 ndë Jerusolim. Edhe ndë qoftë gjë e-vëjejturë  
 të vete edhe unë, dotë vinjënë bashkë me mua.  
 5 Edhe dotë vinj tek ju, si të shkonj ndë-  
 për Maqedhoni, (sepse *ndashti* po shkonj  
 6 ndëpër Maqedhoni;) Edhe mundetë të mbe-  
 tem te ju *ca kohë*, a edhe të dimëronj, që të  
 7 më përcillni ju kudo që të vete. Sepse nukë  
 dua që t'u shoh juve *ndashti* dyke shkuarë;  
 po shprenj të mbetem përënë jush *ca kohë*,  
 8 ndë *më* dhëntë lejë Zoti. Edhe dotë mbetem  
 ndë Efesë gjer të-kremten' e Pentikostisë;  
 9 Sepse m' uhap një der' e madhe edhe *plot* me  
 punë, edhe kundrështarë janë shumë.  
 10 Edhe ndë arthtë Timotheu, vështoni të  
 jetë pa frikë ndër ju; sepse *edhe ay* punon  
 11 punën' e Zotit sikundrë edhe unë. Asndonjë  
 pra të mos e bënë për asgjë; po përcill-e-  
 ni me paqtim, që të vinjë tek unë; sepse po  
 12 e pres bashkë me vëllezëritë. Sa për vëllanë  
 Apollo, i uluçë shumë që të vinte ndër ju  
 bashkë me vëllezëritë; edhe asfare s' deshi të  
 vinjë *ndashti*; po dotë vinjë, kur të ketë nge.  
 13 Rrini sguarë, qëndroni ndë besët; bëhi bu-  
 14 rra, e forcohi. Gjithë punëtë t' uaj letë bë-  
 nenë me dashuri.

- 15 Edhe u lutem juve, o vëllezër, (e dini  
 shtëpin' e Stefanajt, se është pem' e-parë e  
 Aharisë, edhe se e bënë vetëhen'e tyre kusht  
 16 ndë shërbesët të shënjtorevet;) të unjni kryetë  
 edhe ju ndë të-këtillet, edhe ndë çdo njeri  
 që punon bashkë *me ne* edhe mundonetë.  
 17 Edhe gëzonem për të-ardhurit' e Stefanajt  
 edhe të Furtunatit edhe të Ahaikojt, sepse  
 18 këta mbushnë të-shterëtë t' uaj; Sepse prejtnë  
 shpirtinë t' im edhe t' uajnë. Nderoni pra të-  
 këtilletë.  
 19 U falenë juve me shëndet kishët' e Asisë  
 U falenë juve me shëndet mbë Zotinë Aqilla  
 edhe Priskilla bashkë me kishënë *që është*  
 20 ndë shtëpit t' atyreve. U falenë juve me shën-  
 det gjithë vëllezëritë. Përshëndetni njëri tja-  
 tërinë me të-puthurë të-shënjtëruarë.  
 21 Të-faluritë me shëndet *ushkrua* me do-  
 22 rënë t' ime, të Pavlit. Ndë është ndonjë që  
 23 nukë do Zotinë t' ënë Jisu Krisht, letë jetë  
 anathema. *Maran-Atha* \*). Hiri i Zotit Jisu  
 24 Krisht *qoftë* me ju. Dashuria ime *qoftë* me  
 gjithë ju mbë Jisu Krishtinë. Amin.

---

\*) Zoti ynë vjen.